

## **Njëzet vjet Marrëveshja Kornizë e Ohrit**

Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO) ishte një përpjekje ambicioze jo vetëm për të ndaluar luftimet që tronditën vendin në vitin 2001, por edhe për të siguruar planin për një shoqëri të ardhshme, më përfshirëse.

OSBE ishte e angazhuar në vend për mbështetjen e parimeve të përcaktuara në Marrëveshje edhe para nënshkrimit të saj. Përfshirja e reformës së vetëqeverisjes lokale në këtë dokument i detyrohet shumë pjesëmarrjes së Max Van der Stoel, si Përfaqësues Special i Kryesuesit të atëhershëm të OSBE-së, në negociatat e Ohrit. Në rolin e tij të mëparshëm si Komisioner i parë i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, Ambasadori Van der Stoel vizitoi vendin më shumë se pesëdhjetë herë gjatë viteve 1993-2001, duke punuar, ndër të tjera, për përkrahjen e arsimit universitar shumëgjuhësh. Kjo përpjekje u kurorëzua me sukses kur miratimi i Ligjit për arsim, i përshkruar në Marrëveshje, i hapi rrugën themelimit të Universitetit të Evropës Juglindore.

Siç theksohet në Aneksin C të Marrëveshjes, OSBE ka qenë veçanërisht aktive në fushat e ndërtimit të mirëbesimit dhe reformës policore. Ne dërguam vëzhguesit tanë ndërkombëtarë dhe këshilltarët policor në zona të ndjeshme në fazën fillestare pas konfliktit, duke lehtësuar kështu rikthimin gradual dhe të koordinuar të policisë që nga 22 tetor 2001. Ne gjithashtu u përkushtuam ndaj parimit të përfaqësimit të barabartë në shërbimin policor të vendit. Marrëveshja Kornizë na bëri thirrje në mënyrë eksplicite të ndihmojmë në ndërtimin e një shërbimi policor që pasqyronte komunitetet e ndryshme të shtetit, dhe në vitet e para pas nënshkrimit të Marrëveshjes, instruktorët e OSBE-së ishin të rëndësishëm në trajnimin e më shumë se 1000 policëve të rinj nga komunitetet jo-shumicë.

Ne gjithashtu mbështetëm decentralizimin dhe forcimin e vetëqeverisjes lokale. Më 1 korrik 2005, pushteti dhe kompetencat iu transferuan qeverive komunale, me OSBE-në që u angazhua për të lehtësuar këtë proces përmes trajnimit për ngritjen e kapaciteteve për komunat. Në përputhje me decentralizimin dhe Ligjin për gjuhët, të përcaktuara në MKO, tanimë ka komuna në të cilat gjuha shqipe, turke, rome, vllehe dhe serbe gëzojnë status bashkë-zyrtar me gjuhën maqedonase. Kjo nuk do të ishte e mundur para nënshkrimit të Marrëveshjes.

OSBE ka mbështetur shumë nisma të tjera për të rritur kohezionin social, demokratizimin e mëtejshëm, rritjen e tolerancës dhe barazisë, si dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve shtetërore dhe gjyqësorit. Në të gjithë këtë angazhim, ne jemi udhëhequr nga parimet e përfaqësimit të barabartë dhe multietnicitetit të mishëruar në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit.

Ndërsa është e qartë se Marrëveshja Kornizë e Ohrit vendosi vendin në rrugën drejt bërjes së një shteti multi-etnik gjithëpërfshirës, është po aq e qartë se mbetet ende shumë punë për të bërë. Ndërtimi i kohezionit social dhe stabilitetit demokratik në shtetet multi-etnike kërkon përpjekje të qëndrueshme përgjatë dekadave. OSBE mbetet e përkushtuar për t'ju përkrahur në këtë punë të rëndësishme.

Ambasadori Clemens Koja  
Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup  
Shkup, gusht, 2021